



KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

" AL - TEC " SH.P.K., Babush i Muhaxherve, Lipjan me nr bisnezit 810060591, (në vazhdim "Furnizuesi"),
ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizim me:

Pikat ushqyese për qenët endacak numër identifikues: 616-22 006 125

: 616-22-664-1-2-5

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim: "Pikat ushqyese për qenët endacak"

Nr.	616-22 006 125
	Pikat ushqyese për qenët endacak

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi nga data e neshkrimit te Planit te menagjimit **dhe përfundon në afat prej 12 muajve.**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 5 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Prishtine

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi. Vlera totale indikative e kontratës është 76 478,40 (Shtatedhjet e gjashte mijë e katerqinde e shtatedhjet e tete euro e katerdhjet cent) Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është (+;- 30%)

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Komizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhë në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Nexhmi Mekolli	Emri:	Adelina Xhaferi
Pozita:	Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit	Pozita:	Mendëdhënëse
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25-02-2022	Data:	25.02.2022
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Produktet” përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 “Autoriteti Kontraktues” do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 “Furnizues” do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 “Inkotermet” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 “Furnizim” do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 “Çmimi i kontratës” do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 “Shërbimet pas shitjes” do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është batur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njej lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është

specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruara plotësisht me një valute lirish të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç

nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhëra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimi;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të urdhrimit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtjesore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit

mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar

urdrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshhtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërës nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshhtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshhtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë pëmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi , pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi , pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇAN**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	8.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 13 muaj-ve
Sigurimi	9.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Cilësia e furnizimeve	16.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergese të materialit i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 17 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës.
Parimet të përgjithshme të pagesave	18	Kërkesat për pagese do të bëhen për furnizimet e dorëzuara në baza mujore (ex post).Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për furnizimet e dorëzuara në baza mujore (ex post). Nuk ka pagese paraprake.
Dorëzimi	19.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda 5 ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	22.1	[shëno periudhën e garancioni]

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Komisioni per ndermjetsim pranë Ministrise se Drejtesise
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>



RAPORTI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Procedurë e negociuar Pa Publikim të Njoftimit të Kontratës; Vlerë e mesme

Në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data kur është përgatitur Raporti i Vlerësimit: 18.02.2022

Nr. i prokurimit ¹	616-22-664-1-2-5
Nr i brendshëm	616 22 006 125

Titulli: „ Furnzimi , montimi i 18 Pikave ushqyese te qenëve endacak”

¹ Da se izveštava u svakom dokumentu ili zahtevu u vezi sa aktivnost nabavke.

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË ADMINISTRATIVE TË TENDERËVE

Kërkesat formale/administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit

	TENDERUESH (adresa, shtetësi)	Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet	Origjinali i tenderit dhe	Sigurimi i tenderit në pajtueshmëri me kërkesat e dojes së tenderit	Vlefshmëria e tenderit	Kërkesa të tjera formale/administrative (të specifikuara)	TENDERI I PËRGJEGJSHËM ME KËRKESAT ADMINISTRATIVE
1.	“AL - TEC ” SH.P.K., Babush i Muhaxherve, 14000, Lipjan 810060591	Po	Po	Po	90 ditë/	Po	PO/JO Po

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR VLERËSIMIN E PËRSHTATSHMËRISË TEKNIKE TË TENDERËVE

n/a

Rezultati i negociatave	Jane pajtuar te dy palet qe kontrata te lidhet me cmimet e negociuar prej 76.478,40	

- *[Signature]*
- *[Signature]*
- *[Signature]*


OE AF-TEC
[Signature]


LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRFUNDIMIN E NEGOCIATAVE ²

Sipas Nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-042

Nr i kandidatit (1)		Propozimet nga kandidatët															
Lënda e negociatave	Informacioni i dhënë kandidatit	Përshkrim i shkurtër- Çmimi															
<p>»» "Pikat ushqyese për qenët endacak"</p>	<p>Dosja e tenderit</p>	<p>Komisioni i vlersimit gjate negociatave me Operatorin Ekonomik "AL-TEC shpk" kane arritur te negocojne çmimi te jete nga çmimi i ofruar 77.526,00 ne qmimin e negocuar 76.478,40.per pozcionet ne vazhdim:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përshkrimi</th> <th>Çmimi i ofruar(€)</th> <th>çmimi i negocuar (€)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Furnizimi dhe montimio i Shtyllave metalike 40x40 mm të galvanizuara me trashësi 2 mm dhe latrësi 1.8 metra përfshir edhe fundamentin</td> <td>72</td> <td>68.4</td> </tr> <tr> <td>Furnizimi dhe montimi i Rrjetës telë me latrësi 1.8 m</td> <td>80</td> <td>70.40</td> </tr> <tr> <td>Hapja e vrimave me dimensione ø125 mm dhe betonimi i tyre përfshi ankerat</td> <td>250</td> <td>220</td> </tr> <tr> <td>Vendosja e ushqimores metalike me 4 hapësira ne të cilat mund të vendoset ushqimi dhe uji sipas skicave me larte.</td> <td>255</td> <td>240</td> </tr> </tbody> </table>	Përshkrimi	Çmimi i ofruar(€)	çmimi i negocuar (€)	Furnizimi dhe montimio i Shtyllave metalike 40x40 mm të galvanizuara me trashësi 2 mm dhe latrësi 1.8 metra përfshir edhe fundamentin	72	68.4	Furnizimi dhe montimi i Rrjetës telë me latrësi 1.8 m	80	70.40	Hapja e vrimave me dimensione ø125 mm dhe betonimi i tyre përfshi ankerat	250	220	Vendosja e ushqimores metalike me 4 hapësira ne të cilat mund të vendoset ushqimi dhe uji sipas skicave me larte.	255	240
Përshkrimi	Çmimi i ofruar(€)	çmimi i negocuar (€)															
Furnizimi dhe montimio i Shtyllave metalike 40x40 mm të galvanizuara me trashësi 2 mm dhe latrësi 1.8 metra përfshir edhe fundamentin	72	68.4															
Furnizimi dhe montimi i Rrjetës telë me latrësi 1.8 m	80	70.40															
Hapja e vrimave me dimensione ø125 mm dhe betonimi i tyre përfshi ankerat	250	220															
Vendosja e ushqimores metalike me 4 hapësira ne të cilat mund të vendoset ushqimi dhe uji sipas skicave me larte.	255	240															

² Të përdoret vetëm në rast të procedurës konkurruese me negociata



**LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES
"ÇMIMI MË I ULËT"**

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit të LPP

Radhë	Lënda / grupi: Furnizimi , montimi i 18 Piktave ushqyese te qenëve endacak	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	" AL - TEC " SH.P.K., 810060591	76 478,40

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr.r:	Grupi:	Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa	Çmimi i ofruar
1	"Pikat ushqyese për qenët endacak"	"AL - TEC " SH.P.K.,	10000	Babush i Muhaxherve, 14000, Lipjan	76 478,40

DEKLARATË

Komisioni i Vlersimit rekomandon per dhenje te kontartes Operatorin Ekonomik " *AL-TEC shpk* ", me çmim prej 76 478,40€.

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

	Po
--	----

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:


Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit per dhenie te kontrates propozon OE-ik "*AL-TEC shpk*" me cmim 76 478,40€.


KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

1. Kryesuesi

Xhevdet Ibrahimaj


(Nënshkrimi)

2. Anëtar
Halil Halili


(Nënshkrimi)


3. Anëtar

Hateme Gashi


(Nënshkrimi)

Data e përfundimit të raportit dhe vlerësimit të ofertave: 18.02.2022

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit: - UD.Nexhmi Mekolli

Nënshkrimi: 

Data: 18-02-2022

Fundimi me ushqimi
per 18 pike per nie dhe

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi (€)	Shuma (€)
1	Fundimi shpendorja dhe mishi me ushqim e plove ushqimore per 18 pike nga dy here ne dite nga 2.5 x2=5kg	kg	32850	2	65,700
	5 x18 cika =90 kg				
Totali					65,700

Numri	Pershkrimi	Njesia	Kosto	Cmimi (€)	Shuma (€)
1	Fundimi dhe materialimi i Shklyave me cete 40x40 mm te galvanizuar me heshkel 2 mm dhe lartesi 1.8 metra perfisher edhe i ndomemtin	M ²	18	4	72
2	Fundimi dhe montimi i Rrjetit tel me lartesi 1.8 m	m	32	2.5	80
3	Hopja e vrrave me dimejtore 4125 mm dhe betonimi i tyre perfisher ankerat	copë	10	25	250
4	Vendosja e ushqimores me cete me 4 hapesira ne te cilat mund te vendoset ushqimi dhe vijat shicave me larte.	copë	1	255	255
Totali per nie pike 657					
Totali 18 x					11,826

REKAPITULIM

Nr.	Pershkrimi i shkakut	Cmimi
1	Fundimi me ushqimi per 18 pike per nie dhe	180
2	Materialimi i 18 plove ushqimore	11,826
Totali		12,006



PROJEKT PROPOZIM PËR USHQYERJEN E QENËVE ENDACAK NË KOMUNËN E PRISHTINËS – FURNIZIMI ME USHQIM

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT


Problemi i qenëve endacakë tash e sa kohë është bërë problem serioz për qytetarët e Kosovës ani pse ata po trajtohen në bazë të ligjit për trajtimin e kafshëve. Deri më tani Komuna e Prishtinës ka realizuar dhe ende vazhdon të realizojë të gjithë hapat e nevojshëm për trajtimin e qenëve endacak duke filluar nga kastrimi, trajtimi dhe trajnimi i tyre, po ashtu montimi i pikave ku furnizohen në mënyrë të rregulltë me ushqim për qentë endacak.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Konstruksioni për pikat ushqyese të qenëve endacakë të jetë si në formatin e cekur në foton më poshtë.

Të përcaktohen pikat për vendosjen e ushqimoreve të qenëve në territorin e Qytetit të Prishtinës, të cilat vizitohen dhe mbushen çdo ditë me ushqim dhe ujë nga operatori i përzgjedhur. Ushqimorja do të jetë e ndarë në dy pjesë të cilat do të jenë të mbushura njëra me ushqim dhe tjetra me ujë, dizajni i ushqimores do të ketë mbulesën, për t'u ruajtur ushqimi nga reshjet, si në foton më poshtë.





QËLLIMI DHE PËRFITIMET E PROJEKTIT

1. Ulja e agresivitetit të qenëve endacakë – Sipas shumë studimeve theksohet se qentë bëhen agresiv në mungesë të ushqimit, andaj me sigurimin e ushqimit dhe ujit për qentë endacakë arrihet zvogëlimi i agresivitetit të tyre dhe si rezultat rritet siguria e qytetarëve prej sulmeve nga qentë endacakë.

Pastërtia e qytetit – Vlen të theksohet së kontenjerat e mbeturinave janë vendi më atraktiv i qenëve endacakë të paushqyer gjatë kërkimit të tyre për ushqim dhe si pasojë vjen deri tek shpërndarja e mbeturinave në ambientet banuese.

2. çka është shumë shqetësuese për banorët e qytetit, andaj me sigurimin e ushqimit të tyre ruhet edhe pastërtia e qytetit.
3. Imazhi i Komunës – Besojmë se, nëse ndërmerret një hap i tillë për ushqyerjen e qenëve endacakë , imazhi i Komunës së Prishtinës në aspektin e trajtimit të qenëve endacak.

PROPOZIMET PËR LOKACIONET E PIKAVE USHQIMORE

Gjatë hulumtimit për përcaktimin e lokacioneve, faktorët e mëposhtëm janë marrë në konsideratë:

- Lagjet më të frekuentuara nga qentë endacakë
- Vendet, në ato lagje, ku nuk ka banorë dhe nuk janë te frekuentuara nga këmbësorët

- Prona publike (të verifikohen nga Komuna e Prishtinës, respektivisht Drejtoria e Katastrit)
- Periferia / Hyrjet e Prishtinës, aty ku lëshohen qentë endacakë nga komunat e tjera, duke shpresuar që po të njëjtit të ambientohen aty në periferi dhe mos të zbresin në qytet

Implementimi i projektit ne faza:

Për zgjerimin e projektit e projektit me gjithsej 18 pika ushqyese, kurse 5 i kemi aktive të cilat furnizohen me ushqim për çdo ditë ne lokacionet:

1) Rruga C – Pozicionimi në Google maps 42°38'57.0"N 21°10'44.6"E
Mendojmë se kjo do të jetë një pikë e përkohëshme deri në ndërtim të objekteve të banimit në një të ardhme të afërt. Frekuentimi i qenëve është i konsiderueshem dhe do të jetë zgjidhje për një pjesë të Bregut të Bregut të Diellit dhe Lagjës Mati 1.

1) Mati 1 – Pozicionimi në Google maps 42°39'06.1"N 21°11'05.1"E. Dy Pika
Mendojmë se kjo do të jetë një nga pikat më të rëndësishme dhe shumë e frekuentuar nga qentë, gjendet në pozitë të përshtatshme pasi nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, jo shumë afër blloqeve të banimit dhe në këtë pikë propozojmë ti kemi dy ushqimore.

2) Termokos/Termokis – Pozicionimi në Google maps 42°38'55.9"N 21°09'13.3"E
Pikë paksa e papërshtatshme në aspektin e sigurisë pasi që ka frekuentim të këmbësorëve dhe të nxënësve të shkollës Dardania por këtë pikë e propozojmë pasi që stafi i Termokos ushqen një numër të konsiderueshem të qenëve endacakë dhe mendojmë se në koordinim me këtë staf ne vlerësojmë se kjo pikë përbën apo jo rrezik për nxënësit dhe këmbësorët. Kjo pikë nuk shpresojmë të jetë aq shumë e frekuentuar pasi vendosja e ushqimoreve në pjesët periferike të qytetit, zhvendosja e një numri të qenëve nga qendra drejt periferisë dhe parandalimi i ardhjes nga komunat tjera mendojmë se do të koncentrimi i qenëve endacakë në këtë zonë do të jetë më i vogël gjithsesi do të jetë jetë një përkujdesje për pjesën e mbetur të kësaj lagje, në këtë pikë propozojmë një ushqimore

3) Stacioni i autobusave – Parku i Servisit – Pozicionimi në Google maps
42°38'54.2"N 21°08'49.3"E

Kjo pikë ndonëse ndodhen në kompleksin e Stacionit të autobusëve dhe ka një frekuentim shumë të madh të qenëve, mund të mos duket e logjikshme vendosja e ushqimoreve në hapësiat e stacionit por ne e kemi menduar pasi që qentë edhe ashtu frekuentojnë në masë shumë të madhe në hapësirat e brendshme të stacionit dhe të cilët në periudhën e dimrit shumë herë janë agresiv për shkak të mungesës së ushqimit.

Pika e paraparë nga ne është në pjesën jug-perendimore të stacionit të autobusave gjegjësisht tek parku i servisit dhe ka një distancë të konsiderueshme nga kontakti me vizitorët e spitalit, në këtë pikë grumbullon qentë e lagjes Emshir dhe ne propozojmë një pike shtese asaj egzistuese.

- 4) Ish pazari i gjedheve në Kodren e Trimave – Pozicionimi në Google maps
42°42'15.3"N 21°09'17.3"E

Kjo do të jetë një pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjes së Trimave dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshem nga pjesët tjera të Prishtinës, do të parandalon ardhjen e qenëve nga regjioni i Podujevës, pozicionimi i kësaj pike nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.

Faza provuese me 5 pika ushqimore ka rezultuar me sukses te plote ky jane arritur te tri objektivat e parapara ne projekt;

- a. Ulja e agresivitetit të qenëve endacakë – në të gjitha pikat e caktuara nga Komuna fillimisht kishim reagime të qytetarëve për të mos i vendos pikat vetushqyese në afërsi të shtëpive të tyre nga frika se do të jenë të atakuar nga qenet e rrugës dhe problemet e banorëve do të rriteshin nga grumbullimi i qenëve në afërsi të shtëpive të tyre por pas një kohe shumë të shkurter pikerisht ata qytetar te cilet kan reaguat për mos vendosjen e pikave kan qen ata të cilet kan kerkuar shtimin e pikave pasi qenët kan qenë shum miqsor me banoret qysh ne javen e dytë të vendosjes së pikave.
- b. Pastërtia e qytetit – kemi pa plot raste që nga kontenjerët e mbeturinave jan nxjerr dhe shpërnda mbeturina jo vetem në hapësiren përreth kontenjerve por edhe në një sipërfaqe më të madhe duke krijuar një pamje shumë të shëmtuar të qytetit tonë vetem e vetem me siguru qenët e rrugës ekzistencen e tyre, por me vendosjen e pikave vetushqyese ky fenomen nuk vërehet ne ato lokacione ku jan vendosur pikat vetushqyese dhe ne hapsiren përreth.
- c. Imazhi i Komunës – Edhe pse faza provuese ka filluar me numer te vogel te pikave, Komuna e Prishtines merret shembull ne aspektin e trajtimit te qeneve endacak si dhe sigurin e qytetarëve.

Pas vendosjes së konstruksioneve për pikat ushqyese, projekti për furnizim me ushqim të zgjatë 36 muaj.

Vendosja e 18 rrethojave dhe pikave ushqyese, të cekura më poshtë.

1. Mati 1 – Pozicionimi në Google maps 42°39'06.1"N 21°11'05.1"E. Dy Pika

Mendojmë se kjo do të jetë një nga pikat më të rëndësishme dhe shumë e frekuentuar nga qentë, gjendet në pozitë të përshtatshme pasi nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, jo shumë afër blloqeve të banimit dhe në këtë pikë propozojmë ti kemi nje ushqimore shtese asaj egzistuese.

2. Kolovicë – Pozicionimi në Google maps 42°41'11.5"N 21°11'31.2"E
Kjo do të jetë një pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjës Kolovicë dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshem nga pjesët tjera të Prishtinës dhe do të ndikonte sadopak në uljen e numrit të qenëve në qendër, gjendet në pozitë të përshtatshme pasi nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.
3. Rruga e Medreses – Pozicionimi në Google maps 42°41'30.6"N 21°10'39.6"E
Kjo do të jetë një nga pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjës Kolovica dhe Lagjes së Trimave dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshem nga pjesët tjera të Prishtinës , nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, është afër shtyllës së tensionit të lartë dhe nuk mendojmë se në këtë hapësirë do të ketë mundësi ndërtimi të objekteve të banimit, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.
4. Lagjja Vreshta – Pozicionimi ne Google maps 42°40'28.9"N 21°11'28.0"E
Kjo do të jetë nga pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjës dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshem nga pjesët tjera të Prishtinës pozicionimi i kësaj pike nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.
5. QKUK – Pozicionimi ne Google maps 42°38'29.3"N 21°09'31.4"E
Kjo pikë ndonëse ndodhet në kompleksin e Qendrës klinike Universitare të Kosovës dhe ka një frekuentim shumë të madh të qenëve, mund të mos duket e logjikshme vendosja e ushqimoreve në një institucion mjaft të rëndësishëm siç është QKUK por ne e kemi menduar pasi që qenët edhe ashtu frekuentojnë në masë shumë të madhe në hapësirat e brendshme të QKUK-së dhe të cilët në periudhën e dimrit shumë herë janë agresiv për shkak të mungesës së ushqimit. Pika e paraparë nga ne është në pjesën jugore të QKUK-së dhe ka një distancë të konsiderueshme nga kontakti me vizitorët e spitalit. Ne kete pike propozojme **dy ushqimore**
6. Veternik – Pozicionimi ne Google maps 42°38'09.9"N 21°10'38.2"E
Kjo do të jetë një pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjës së spitalit dhe Veternikut dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshëm nga pjesët tjera të Prishtinës nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për

këmbësorë, është afër shtyllës së tensionit të lartë dhe nuk mendojmë se në këtë hapësirë do të ketë mundësi ndërtimi të objekteve të banimit
Kjo do të jetë edhe një pikë e cila i grumbullon qentë të cilët mund të vinë nga Komunitet e tjera siç janë Lipjani dhe Graçanica. Në këtë pikë propozojmë t'i kemi **dy ushqimore**

7. Arbëri te varrezat – Pozicionimi në Google maps 42°40'36.8"N 21°08'36.5"E
Kjo do të jetë edhe një pikë e cila i grumbullon qentë të cilët mund të vinë nga Komunitet e tjera siç janë Obiliqi dhe Vushtrria, nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore
8. Qendra e Arsimit profesional – Pozicionimi në Google maps 42°38'48.0"N 21°08'20.2"E
Mendojmë se kjo do të jetë një nga pikat më të frekuentuar nga qentë, gjendet në pozitë të përshtatshme pasi nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, jo shumë afër blloqeve të banimit kjo pikë mund të shërbejë edhe si parandalim i ardhjes së qenëve nga komuna e Fushë Kosovës, në këtë pikë propozojmë t'i kemi **dy ushqimore**.
9. Stacioni i autobusave – Parku i Servisit – Pozicionimi në Google maps 42°38'54.2"N 21°08'49.3"E
Kjo pikë ndonëse ndodhen në kompleksin e Stacionit të autobusëve dhe ka një frekuentim shumë të madh të qenëve, mund të mos duket e logjikshme vendosja e ushqimoreve në hapësiat e stacionit por ne e kemi menduar pasi që qentë edhe ashtu frekuentojnë në masë shumë të madhe në hapësirat e brendshme të stacionit dhe të cilët në periudhën e dimrit shumë herë janë agresiv për shkak të mungesës së ushqimit.
Pika e paraparë nga ne është në pjesën jug-perendimore të stacionit të autobusave gjegjësisht tek parku i servisit dhe ka një distancë të konsiderueshme nga kontakti me vizitorët e spitalit, në këtë pikë grumbullon qentë e lagjes Emshir dhe ne propozojmë një pike shtese asaj egzistuese.
10. Zllatar – Pozicionimi në Google maps 42°38'20.7"N 21°12'26.8"E
Kjo do të jetë një nga pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjes Zllatar dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshëm nga pjesët tjera të Prishtinës pozicionimi i kësaj pike nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.
11. Lagjja Sofali - Pozicionimi në Google maps 42°40'08.8"N 21°12'13.1"E
Kjo do të jetë një pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjes Sofali dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshëm nga pjesët tjera të Prishtinës pozicionimi i kësaj pike nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.

12. Ish kazerma e armatës (afër Tokbashqes) - Pozicionimi në Google maps
42°39'46.7"N 21°11'23.1"E

Kjo do të jetë një pikat e cila do t'i grumbullonte qentë e lagjes Togbashqe dhe do t'i tërhiqte edhe një numër të konsiderueshëm nga pjesët tjera të Prishtinës pozicionimi i kësaj pike nuk është e ngarkuar si lagje banimi, nuk përbën rrezik për këmbësorë, në këtë pikë propozojmë një ushqimore.

Pikat të cilat i paramendojmë si testim nese përbëjnë rrezik apo jo për qytetarët tonë janë:

1. Ulpiana – Pozicionimi në Google maps 42°39'00.5"N 21°09'40.6"E
2. Kompleksi i Universitetit – te Kisha – Pozicionimi në Google maps 42°39'29.6"N 21°09'48.9"E
3. Te Spitali – përballë TMK-së – Pozicionimi në Google maps 42°38'46.3"N 21°09'58.5"E

Konsiderojmë se nëse vendosen pikat periferike dhe ndalohet ardhja e qenëve endacakë nga komunat tjera, këto pika ushqyese nuk do të përbëjnë rrezik për qytetarët pasi numri i tyre në brendësi të qytetit dukshëm do të bie.


Të gjitha pozicionet e prezantuara janë parë si mundësi reale dhe një zgjidhje afatgjate e problemeve, por nga ana drejtorisë përkatëse presim më në detaje përcaktimin e pronave komunale dhe mundësinë që sa më pak të kemi probleme me banorët lokal.



Figura 1. Paraqitje grafike e vendndodhjes së pikave ushqyese për qenë sipas përshkrimit të lartëshënuar




PËRSHKRIM I SHKURTËR I HAPËSIRËS GRUMBULLUESE DHE USHQIMOREVE. Skica e konstruksionit

- Hapësira ku mendojmë të vendosim ushqimoret mundet me pas një sipërfaqe prej 16 m² dhe ne e paramendojmë të rrethuar me një rrjetë teli e cila do ishte shumë e përshtatshme për ushqim të qenëve pa e ndjerë shqetësimin nga personat që kalojnë në afërsi dhe këmbësorët eventual do të ndjeni një siguri më të madhe kur i shohin të rrethuar. Aspekti tjetër i nevojës për rrethim është se do të jetë shumë ma e lehtë kapja për vaksinim dhe kastrim dhe e treta dhe jo më pak e rëndësishme se ata do të jenë të shoqëruar dhe të bashkuar në një hapësirë të dedikuar pikërisht atyre. Kjo hapësirë mund të ndryshojë varësisht nga mundësia e komunës për të ofruar hapësirë më të madhe.



- Ushqimoret i kemi planifikuar të jenë të metalit dhe në të duhet të jenë të ndara në dy hapësira në të cilat mund të vendoset ushqimi dhe uji dhe të jenë të mbuluara që mos të vijë deri te lagia nga kushtet atmosferike.

- Pikat ushqyese duhet te furnizohen dhe shpërndarja e ushimit te behet dy here ne dite nga 2.5kg. Qe do te thotë 5 kg ne dite per secilën pike ushyese.





POPPINS
www.poppins.biz

AL-TEC SHPK.
www.altec-ks.com



DEKLARATË MBI AFATIN E LIFERIMIT

Në lidhje me kërkesen e dosjes së tenderit me Titull: **“Pikat ushqyese për qenët endacak”** dhe **616 22 006 125 Deklarojmë** per afatin kohore per fillim dhe/ose perfundimin e kontrates sipas percaktimit ne dosjen e tenderit.

Me dt. 16/02/2022

“AL-TEC”
SH.P.K. Adem Zeneli Nr. 101,
Babush i Muhaxhereve,
Lipjan, RKS



Xhavit Duka
Direktor

+383 38 400 991; +383 49 114 811; +383 48114811

info@poppins.biz; info@altec-ks.com

www.poppins.biz; www.altec-ks.com

Rr. Adem Zeneli, Nr. 101, Babush i Muhaxherëve, 14000 Lipjan





POPPINS
www.poppins.biz

AL-TEC SHPK.
www.altec-ks.com



DEKLARATË MBI SPECIFIKIMET TEKNIKE

Në lidhje me kërkesen e dosjes së tenderit me Titull: **“Pikat ushqyese për qenët endacak”**
dhe 616 22 006 125

Deklarojmë se produktet e ofruara janë konformë me specifikimet teknike të detyrueshme në
Anex 1. nga dosja e tenderit.

Me dt. 16/02/2022

“AL-TEC”
SH.P.K. Adem Zeneli Nr. 101,
Babush i Muhaxhereve,
Lipjan, RKS

Xhavit Duka
Drejtor



+383 38 400 991; +383 49 114 811; +383 48 114811

info@poppins.biz; info@altec-ks.com

www.poppins.biz; www.altec-ks.com

Rr. Adem Zeneli, Nr. 101, Babush i Muhaxherëve, 14000 Lipjan




ANEKSI 2**DEKLARATA NËN BETIM**

Për: **KK Prishtina**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: **Al-Tec Sh.p.k.** deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	AL-TEC SH.P.K.
Adresa e plotë:	Rr. Adem Zeneli Nr.101 – Babush i Muhaxhereve, Lipjan
Tel:	048 11 48 11
Email:	info@poppins.biz
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Xhevdet Duka
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	16.02.2022
Vula:	



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr 100392

Për KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **AL - TEC SH.P.K.**

(Emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim-Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **"Pikat ushqyese për qenët endacak"**

Nr. prokurimit: 616-22-006-125 , Nr. brandshëm: 616-22-006-125

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues,

dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **7,800.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autorteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 7,800.00€ siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 400 ditë kalendarike prej **16.02.2022** deri më **23.03.2023**

Data lëshimit: 16.02.2022

Nënshkrim dhe vula e garantuesit

Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





Republika e Kosovës
NOTER
EKREM NUHIU
GRAÇANICË
A U T O R I Z I M

LRP.nr.rend. 4026/2021

Më njëzet e dy shtator dymijë e njëzet e një (22.09.2021), para meje Ekrem Nuhiu, Noter me seli në Graçanicë, paraqitet:-----

1. "AL-TEC " SH.P.K. me seli në Adem Zeneli, nr.101, Babush I Muhaxherëve, Lipjan e regjistruar pranë MTI-së me nr.unik identifikues 810060591, përfaqsuar nga drejtori z.Xhevdet Duka, i lindur më 11 shtator 1969 në Drenoc, shtetas i R.Kosovës, bartës i letërnjoftimit me numër ID0694785, me nr.personal 1010001559, lëshuar nga MPB-e RKS, më 20.02.2017, i vlefshëm deri më 19.02.2027, me vendbanim në Prishtinë, me zotësi juridike për të vepruar i cili:-----

A U T O R I Z O N, -----

2. Adelina Xhaferi, e lindur më 22.07.1980, në Prishtinë, shtetase ie R.Kosovës, bartëse ie letërnjoftimit me nr.personal 1011081718, me vendbanim në Prishtinë(I autorizuar)-----

Në emër të kompanisë të ndërmerr të gjitha veprimet dhe ti nënshkruaj dokumentet e nevojshme para të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, qofshin ato Komunale apo Qeveritare (Adminstatave Komunale, Ministrive, kompetente) për çështje administrative dhe çështje të tjera .- Të kryej të gjitha punët e nevojshme-për regjistrimin e pronave në Kadastrat Komunale të cilësdo Komunë në Republikën e Kosovës (paraprakisht duke u pajisur me vërtetimin që është paguar tatimi në pronë) dhe më pas të nxjerrë fletët poseduese, kopjet e planeve dhe vërtetimet që ngastrat nuk janë të ngarkuara me hipotek, për pronat në pronësi të kompanisë.-----

Të mund të vërtetoj dokumente tek noteri për ndërrmarjen në fjalë.-----

Që për nevojat e kompanisë të përfaqësoj pranë të gjitha zyrave doganore në R.Kosovës, si dhe të autorizoj Agjencionet e Shpeditimit, për export-import.-----

Të përfaqësojë entin biznesor në të gjitha instancat e Gjykatave në Kosovë sipas nevojës -----

-Kompaninë e njëjta autorizohet ta përfaqësoj pranë ndërrmarjeve publike si, KEDS-it , ujësjellësit ,pastrimit(pranë të njejtave të ketë të drejtë të nënshkruaj çdo document të nevojshëm administrative në lidhje me ndërrmarjen) si dhe pranë shërbimeve tjera komunale.---

Të na përfaqsoj në Agjensionin Tatimor të Kosovës ATK dhe Agjensionin per Regjistrimin e Bizneseve ne Kosove – ARBK -----

Të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale pranë cilit do organ në të gjitha Komunitat në territorin e R.Kosovës, për të gjitha qështjet, ku palë pranë komunave ose organeve komunale është enti biznesor në fjalë.-----

Të mund të autorizoj të gjithë puntorët e ndërrmarjes për vozitjen e automjeteve të ndërrmarjes në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe e njejta vet të mund të shfrytëzoj të gjitha automjetet e ndërrmarjes.-----

Noteri i lexon aktin palës, i cili e kuptoi dhe e pranoi si vullnet të vetin dhe të cilin së bashku me Noterin e nënshkruan.-----

Shpenzimet e këtij akti Noterial i bartë dhënësi i autorizimit, në shumën prej 11,80 euro përfshir TVSH-në, në bazë të nenit 21.paragrafi 8. të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2012 për TPN Ky akt u përpilua në zyrën e Noterit në Graçanicë, më njëzet e dy shtator dymijë e njëzet e një. (22.09.2021)

Dhënësi i autorizimit

"AL-TEC" SH.P.K.
Xhevdet Dukaj



NOTERI

Ekrem Nuhiu

